

Elbasan, 18 Janar, 2014

Unioni i Gazetareve deklarohet per reagime dhe proteste ndaj gjendjes se rende sociale te gazetareve

Elbasan: Unioni i Gazetarëve thirrje për protesta

Mbi 90 perqind e mediave në Shqipëri janë zhytur në krizë financiare, duke bërë që të mos shlyejnë pagat e gazetarëve dhe të punonjësve. Kjo gjendje po vjen duke u përkeqësuar duke i cuar në faliment shumë media. Këtë gjë e bëri të ditur kryetari i unionit të Gazetarëve të Shqipërisë Aleksandër Cipa nga qyteti i Elbasanit. I pranishëm në procesin e zgjedhjeve për kryetar, nënkryetar, dhe sekretar të përgjithshëm të Unionit të Gazetarit në Elbasan Cipa u shpreh se "media shqiptare po përballet me probleme thelbësore, ku pasojat e këtyre problemeve dhe sidomos krizës financiare, po i vuajnë gazetarët dhe punonjësit në media". Ai u shpreh se vec krizës dhe pagave të vonuara nga pronarët e medias, një shqetësim tjetër mbetet informaliteti. "Ne kërkojmë që institucionet publike shtetërore shqiptare të njohin krizën financiare në media. Kërkojmë që këto insitucione të bëjnë të ditur informalitetin në median shqiptare.

Unioni i Gazetarëve Shqiptarë denoncon faktin që në gjykata të vecanta të Republikës së Shqipërisë po shtohen procese gjyqësore me administratorët e medias për shkak të pagave të padhëna dhe të vonuara. "Për shkak të largimeve nga puna pa dhënë arsye ligjore dhe pa dhënë arsye adminstrative, brenda muajit të ardhshëm ne do të organizojmë protestën e parë për këtë situatë që përkeqëson gjendjen e gazetarëve shqiptarë" tha Cipa . Gjithashtu ai i bëri thirrjeve institucioneve ndërkombëtare që veprojnë në shqipëri dhe që monitorojnë lirinë e medias, të bëhen pjesë e negocimit për pavarësinë e medias. "Ne i bëjmë thirrje OSBE-së dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare që ndjekin dhe monitorojnë situatën e lirisë dhe pavarësisë së medias në Shqipëri, të bëhen pjesë e negocimit për këto çështje të cilat kanë lidhje drejtëpërsëdrejti me pavarësinë dhe lirinë e medias në Shqipëri."

Gjithashtu Unioni i Gazetarëve Shqiptarë ngre zërin për mënyrën se si po vonohet procesi për konstituimin e medias publike në Shqipëri, e cila është një media e neglizhuar. Janë shkelur të gjitha afatet kohore ligjore për zgjedhjen e institucioneve drejtuese, dhe askush nuk e mban përgjegjësinë për këtë shkelje të ligjit. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë arrin në konkluzionin se kur injorohen ligjet dhe procedimet ligjore për median publike, mendo se sa lehtësisht mund të përdhosen mediat private dhe ato të pavarura.

Këto deklarat Aleksandër Cipa i bëri nga qyteti i Elbasanit ku mori pjesë në zgjedhjen e kryetarit të ri të degës së unionit të gazetarëve për qarkun e Elbasanit. Në këtë post u rikonfirmua gazetari Besim Dybeli, që e mbante këtë post edhe më parë, dhe sekretare e përgjithshme e këtij unioni Miranda Sadiku, nenkryetar I Unionit , Fatos Salliu si dhe dy anetare te kryesise , Fatmir Popja dhe Bruna Kyrçyku.

Unioni i Gazetareve Shqiptare